
 <b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosovo</b>	<b>ZYRA E PERSONELIT</b> <b>KANCELARIJA OSOBLJA</b>		 <b>Komuna e Istogut</b> <b>Opština Istok</b>
	<b>02 Nr.188 /18</b>	<b>Data:</b> <b>27.09.2018</b>	

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. dhe 2. të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, Komuna e Istogut ,shpall:

### K o n k u r s

#### Për kryerjen e punëve me kontratë për kohë të caktuar

Vendi i punës: Motër Edukatore  
 Institucioni : Institucioni Parashkollor " Gëzimi Ynë " në Istog  
 Numri i Ekzekutuesve: 1 ( një )  
 Numri i referencës:02Nr.188 /18  
 Paga mujore: 350 € në muaj  
 Kohëzgjatja e Emrimit : Me afat të caktuar - 1 ( një ) vit  
 Orari i plotë : 40 orë në javë

#### Detyrat :

- 1.Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës.
- 2.Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- 3.Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon.
- 4.Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos kominikuar këto informata me asnjë person fizik apo juridik, përveç kur informatate tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kësaj kontrate apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
- 5.Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
6. I punësuari është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.
7. I punësuari sipas kësaj kontrate, nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.
- 8.Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës si dhe punë të tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

#### Kushtet për punësim :

- Të tërë të kryer Fakultetin e Edukimit-programi për fëmijërin e hershme 0-3 vjeç, në mungesë të kësaj përgaditjeje për këtë pozitë të drejtë konkurimi kanë edhe kandidatët që kanë të kryer shkollën e mesme të mjekësisë-drejtimi infermiere edukatore; Shkolla e mesme e mjekësisë-drejtimi i pediatriisë: Shkolla e mesme e mjekësisë-drejtimi - mami dhe Shkolla e mesme e mjekësisë së nëroithshme.

- E preferueshme të ketë përvojë pune në profesion.

**Dokumentacioni i nevojshëm;**

- Kopja e dokumentacionit të kualifikimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës nëse ka;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikata e lindjes apo ekstrakti i lindjes;
- Dy rekomandime;
- Dëshmi që nuk jeni i ndjekur penalisht.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

Afati i aplikimit: Konkursi është i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 27.09.2018 deri më datë : 11.10.2018

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.



Menaxheri i Peronelit  
Fatmir Bytyçi